

### Mbyllet Java Botërore e Investitorit

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-shtator 2019

### Zhvillime të tjera

- Trajtimi i dëmeve, AMF në mbështetje të konsumatorëve
- Banka Botërore mbështet AMF-në me projektin e ri për tregjet e kapitaleve dhe sigurimeve
- Projekte bashkëpunimi për zhvillimin e mikrosigurimeve
- Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare publikon “Gjeografinë e Sigurimeve 2018”
- Zhvillohet Konferenca e XI-të Ndërkombëtare e Sigurimeve
- Konferencë mbi tendencat e zhvillimeve të sigurimeve dhe ndikimi i tyre në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore
- Takimi i 18-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore
- AMF rrit kapacitet njerëzore nëpërmjet trajnimeve

### Edukimi i Konsumatorit

- Skema e Pensioneve në Bullgari, Rumani dhe Republikën Çeke

### Botime Profesionale

### Lajme Ndërkombëtare

- Bullgari
- Evropa Qendrore dhe Lindore
- Greqi
- Poloni
- Slloveni
- Ukrainë

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## Java Botërore e Investitorit i jep një nxitje edukimit dhe mbrojtjes së investitorëve

Më 6 tetor u mbyll edicioni i tretë i Javës Botërore të Investitorit. Gjatë një jave anëtarët e Organizatës Ndërkombëtare të Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) si rregullatorë, bursa, shoqata investitorësh nga mbi 90 juridiksione morën pjesë dhe organizuan aktivitete për të nxitur edukimin dhe mbrojtjen e investitorëve. Tematikat ishin që nga ato të njohurive bazë për investime të zgjuara, investimet online dhe asetet digjitale.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë Javës Globale të Investitorit organizoi dhe udhëhoqi një seri aktivitete të fokusuar në grupe të ndryshme si bizneset, studentët dhe nxënësit e shkollave profesionale. Me prezantime të ndryshme në media drejtues të Autoritetit prezantuan zhvillimet aktuale të tregut të kapitalit në vend, treguan mundësitë se si ky kapital mund të përdoret për të sjellë zhvillim të mëtejshëm në ekonominë e vendit.

Prezantimet mediatike nga Drejtori i Përgjithshëm i Autoritetit, Z. Ervin Koçi, përcollën mesazhin se një bashkëpunim dhe informim më i mirë mbi mundësitë që ofron tregu i kapitalit në vend, do të nxisë zhvillimin e ekonomisë duke rritur investimet si në numër ashtu edhe në vlerën e kapitalit që hyn në ekonomi.

---

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare gjatë Javës Globale të Investitorit organizoi dhe udhëhoqi një seri aktivitete të fokusuar në grupe të ndryshme si bizneset, studentët dhe nxënësit e shkollave profesionale.

---

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, janar-shtator 2019


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-shtator 2019 kapën vlerën mbi 12,839 milionë lekë, ose 3.04% më shumë se në periudhën janar-shtator 2018. Gjatë periudhës janar-shtator 2019, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 992,212 me një rritje 3.83% krahasuar me periudhën janar-shtator 2018.

Tregu vazhdoi të mbetet sërish i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 92.73% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, duke i lënë përkatësisht sigurimet e Jetës me 6.96% dhe veprimtarinë e risigurimit me 0.30%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 36.82% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 63.18% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-shtator 2019, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 4,277 milionë lekë, ose 5.80% më shumë se në periudhën janar-shtator 2018.

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto për periudhën janar-shtator 2019 kapën vlerën mbi 12,839 milionë lekë, ose 3.04% më shumë se në periudhën janar-shtator 2018.

### Struktura e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2019




# ZHVILLIME TË TJERA

## Trajtimi i dëmeve, AMF në mbështetje të konsumatorëve

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për 9 muajt e parë të vitit 2019 ka trajtuar 71 ankesa të ardhura nga qytetarët dhe subjekte të tjera, që lidhen kryesisht me tregun e sigurimeve. Ankesat e trajtuara nga Drejtoria e Mbrojtjes Konsumatore janë bërë kryesisht për masën e dëmshpërblimit në rastet e aksidenteve rrugore.

Autoriteti u bën apel qytetarëve që të kontaktojnë për çdo problematikë në lidhje me shoqëritë e tregjeve nën mbikëqyrje, ndërsa mbetet i angazhuar maksimalisht për trajtimin efikas dhe transparent të ankesave të tyre.



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për 9 muajt e parë të vitit 2019 ka trajtuar 71 ankesa të ardhura nga qytetarët dhe subjekte të tjera, që lidhen kryesisht me tregun e sigurimeve.

Ata mund t'i depozitojnë ankesat e tyre në platformën tonë online, në linkun <https://crm.amf.gov.al/> ose të kontaktojnë me Autoritetin përmes adresës së posaçme të e-mailit, që gjendet në faqen zyrtare të AMF, [konsumatori@amf.gov.al](mailto:konsumatori@amf.gov.al), si dhe numrit të telefonit +355 4 22 57 560. Gjithashtu mund të na shkrujnë në faqen zyrtare të AMF në Facebook.

Në mbrojtje të qytetarëve, AMF ka realizuar disa ndryshime në Rregulloren nr. 53 "Për trajtimin e dëmeve që mbuloohen nga kontrata e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit". Ndryshimet e kryera saktësojnë disa elementë të rëndësishëm, nga afatet e dëmshpërblimit, deri te procedura dhe mjetet e njoftimit të konsumatorit.

Ndryshimi i parë është bërë në nenin 3 që lidhet me paraqitjen e kërkesës për dëmshpërblim, ku në pikën 2 janë shtuar dy nënpika sqaruese si më poshtë:

2.1 Për qëllim të këtij neni, data e marrjes së kërkesës për dëmshpërblim quhet data e depozitimit të kërkesës së bashku me dokumentacionin e plotë shoqërues.

2.2 Në rastet kur kërkesa e paraqitur nuk është e plotë, shoqëria e sigurimit i drejtohet paraqitësit të kërkesës me shkrim brenda 8 ditëve pas pranimit të kërkesës dhe kërkon plotësimin e dokumentacionit.

Ndryshimi tjetër është bërë në nenin 6, që lidhet direkt me afatet dhe procedurën e trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim, ku është specifikuar se:

Në përfundim të trajtimit të kërkesës për dëmshpërblim:

- Në rast pranimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë palën e dëmtuar për masën e dëmshpërblimit të vlerësuar prej saj;
- Në rast refuzimi të kërkesës, shoqëria e sigurimit duhet të njoftojë me shkrim palën e dëmtuar për refuzimin dhe shkaqet ligjore, që çojnë në këtë refuzim.

Shoqëria e sigurimit do të kryejë pagesën e dëmshpërblimit brenda 14 ditëve pas përfundimit të afatit të trajtimit të dëmit dhe nënshkrimit të deklaratës së pranimit të dëmshpërblimit.

Ndryshimi tjetër ka të bëjë me mënyrën e informimit të konsumatorit, ku përveç letrës rekomande është shtuar edhe posta elektronike, apo mesazhi në telefon, në rastet kur këto të dhëna paraqiten nga kërkuesi për dëmshpërblim në formularin që ai plotëson pranë shoqërisë së sigurimit.

## Banka Botërore mbështet AMF-në me projektin e ri për tregjet e kapitaleve dhe sigurimeve

Drejtues të lartë të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare u takuan më datë 9 tetor me përfaqësues të misionit të Bankës Botërore për të diskutuar në lidhje me projektin e ri të asistencës që pritet të nisë së shpejti, në tregun e kapitaleve dhe tregun e sigurimeve.



*Kryetari i Bordit, Z. Ervin Mete dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi gjatë takimit me përfaqësuesit e Bankës Botërore*

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit, Z. Ervin Koçi e vlerësoi si shumë të rëndësishëm projektin e ri që pritet të nisë, në kuadër të zbatimit të strategjisë 5-vjeçare për "Zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje", si edhe rritjes së edukimit financiar të qytetarëve.

Në takim, Kryetari i Bordit, Z. Ervin Mete dhe Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi falenderuan përfaqësuesit e Bankës Botërore për mbështetjen e vazhdueshme në drejtim të kualifikimit profesional, përmirësimit të infrastrukturës ligjore dhe zhvillimit të kapaciteteve mbikëqyrëse.

Kryetari i Bordit, Z. Ervin Mete vlerësoi mbështetjen e vazhdueshme të Bankës Botërore përmes projekteve për Autoritetin, gjë që ka sjellë jo vetëm produkte konkrete, siç janë projektligjet e hartuara për tregjet nën mbikëqyrje, por edhe asistencën e ekspertëve më të mirë ndërkombëtarë të fushës.

Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit, Z. Ervin Koçi e vlerësoi si shumë të rëndësishëm projektin e ri që pritet të nisë, në kuadër të zbatimit të strategjisë 5-vjeçare për "Zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje", si edhe rritjes së edukimit financiar të qytetarëve.

Projekti i ri i asistencës do të ndihmojë Autoritetin në realizimin e objektivit madhor të vendosur në strategjinë 2018-2022 "Për zhvillimin e AMF-së dhe tregjeve nën mbikëqyrje", që synon të kthejë tregjet më të brishta financiare jobankare në Ballkanin Perëndimor, në tregjet më të konsoliduara të rajonit, me kontribut direkt në rritjen ekonomike të vendit.



## Projekte bashkëpunimi për zhvillimin e mikrosigurimeve



Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare po zhvillon një projekt për të nxitur zhvillimin e mikrosigurimeve në vend. Projekti mbështetet financiarisht nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Zhvillim Ndërkombëtar, USAID dhe zbatohet nga Korpusi Vullnetar i Shërbimeve Financiare, FSVC.

Gjatë periudhës 28 tetor–1 nëntor eksperti i tregjeve financiare Peter Wrede zhvilloi takime me përfaqësues të tregut si edhe anëtarë të stafit të AMF-së që mbikëqyrin tregun e sigurimeve, për të diskutuar mbi mundësitë e zhvillimit të produkteve të reja dhe mikrosigurimeve të cilat plotësojnë më mirë nevojat e konsumatorit në vend.

FSVC është një ndër partnerët e rëndësishëm të AMF-së në zhvillimin e projekteve si në drejtim të rritjes së kapaciteteve institucionale të AMF-së, plotësimit dhe përmirësimit të kuadrit rregullator dhe kapaciteteve mbikëqyrëse të AMF-së.

## AMF publikon “Gjeografinë e Sigurimeve 2018”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, publikon Gjeografinë e Sigurimeve 2018 e cila pasqyron në mënyrë të detajuar shpërndarjen e primeve të shkruara bruto, dëmeve të paguara si edhe primit për frymë, sipas prefekturave.

Duke analizuar shpërndarjen gjeografike të primit të shkruar bruto, vërehet një përqendrim i tregut të sigurimeve në prefekturat e mëdha, si Tirana me 61.26% të totalit të primeve të shkruara bruto gjatë vitit 2018, Durrësi me 7.73%, Fieri 5.08%, Shkodra 4.84%, Vlora 4.20%, Korça 4.10%.



GJEOGRAFIA  
E  
SIGURIMEVE  
2018

**amf**  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Një tregues tjetër i rëndësishëm i tregut të sigurimeve është dendësia e sigurimeve që për vitin 2018 ishte rreth 5,893 lekë për frymë, me një rritje rreth 280 lekë krahasuar me një vit më parë.

Përsa i përket primit për frymë sipas prefekturave, prefektura Tiranë me 11,544 lekë për frymë zë vendin e parë, e pasuar nga prefektura Gjirokastër me 5,750 lekë për frymë dhe më tej Durrësi me 4,493 lekë për frymë, Shkodra me 4,023 lekë për frymë dhe Vlora me 3,738 lekë për frymë.

## Zhvillohet Konferenca e XI-të Ndërkombëtare e Sigurimeve

Në datat 3–4 tetor, në Stamboll, Turqi, u zhvillua Konferenca e XI-të Ndërkombëtare e sigurimeve mbi rolin e teknologjisë dhe inovacionit për zhvillimet e qëndrueshme të sigurimeve financiare dhe kibernetike.

Çështjet kryesore që u diskutuan gjatë konferencës ishin:

### Roli i teknologjisë dhe inovacionit për zhvillimet e qëndrueshme

Ndikimi që ka zhvillimi teknologjik është shumë i madh. Ky ndikim shoqërohet me ndryshime në pritshmërinë e konsumatorëve dhe rrjedhimisht, lind domosdoshmëria për ndryshime të akteve rregullatore. Sipas kësaj qasjeje u diskutua gjithashtu dhe rëndësia që ka “fokusi” në tregun e sigurimeve si pasojë e zhvillimeve. Shembuj konkret që të çojnë në menaxhime të suksesshme janë p.sh. përqendrimi i fokusit nga “Reduktimi i ndikimit financiar” në “Reduktimin e riskut”, nga “Menaxhimi i të ardhurave”, në “menaxhimin e rrezikut”, etj.

### Sigurimet në kohën e dixhitalizimit

Teknologjia po ndryshon formën e biznesit. Nga viti në vit shihen ndryshime si pasojë e teknologjisë. Në krye të risqeve dhe sfidave më të mëdha në tregun e sigurimeve: Jetë, Jo-Jetë, risigurim etj., në Turqi por dhe në të gjithë botën janë Teknologjia dhe Rreziqet Kibernetike.

### Hapat e menaxhimit të konsumatorit

Me zhvillimin e teknologjisë gjithçka ka ndryshuar dhe është kthyer në sfidë. Çfarë duhet të mbahet parasysh në lidhje me konsumatorit përmbledhet në tri hapa kyçe, njih konsumatorin, kuptoji nevojat dhe gjej zgjidhjet.

Në datat 3–4 tetor, në Stamboll, Turqi, u zhvillua Konferenca e XI-të Ndërkombëtare e sigurimeve mbi rolin e teknologjisë dhe inovacionit për zhvillimet e qëndrueshme të sigurimeve financiare dhe kibernetike.



Inovacioni përmes teknologjive të reja është një ndër shkaktarët kryesorë të ndryshimit në sektorin financiar. Sektori i sigurimeve nuk është një përjashtim nga zhvillimet e tilla, me mundësi të metodave të reja të ofrimit të shërbimeve.

Sigurimi luan një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin e një organizate të qëndrueshme të biznesit përmes metodave, produkteve dhe shërbimeve të saj në ndryshim. Parimet për sigurimin e qëndrueshëm, sigurojnë një hartë globale për të zhvilluar dhe zgjeruar sistemin inovativ të administrimit të rrezikut dhe zgjidhjet e sigurimeve si rreziqe kibernetike dhe financiare.

Legjislacioni i ri evropian, sjellja e konsumatorëve, zhvillimi i shpejtë dhe dixhitalizimi janë duke sfiduar shoqëritë e sigurimeve.

Përfaqësuesit e AMF-së prezantuan informacionin lidhur me situatën aktuale të zhvillimit të tregjeve dhe të ndryshimeve legjislative.

## **Pjesëmarrje në programin me asistencë teknike për zhvillimin e manualit të zbatueshmërisë**

Organizata Ndërkombëtare e Komisioneve të Letrave me Vlerë (IOSCO) në bashkëpunim me Komisionin e Letrave me Vlerë të Republikës së Maqedonisë së Veriut zhvilluan në periudhën 15-17 tetor, në Shkup, Maqedoni fazën e tretë të programit me asistencë teknike për zhvillimin e manualit të zbatueshmërisë.

Qëllimi i fazës së tretë të këtij projekti ishte prezantimi i draft manualeve të zbatueshmërisë në përputhje me legjislacionin e vendit përkatës dhe të parimeve të IOSCO-s, si dhe informacionet e përgatitura nga gupet pjesëmarrëse në mënyrë që të përdoren nga anëtarët e projektit në juridiksionet e institucioneve të tyre.

Përfaqësuesit e AMF-së prezantuan informacionin lidhur me situatën aktuale të zhvillimit të tregjeve dhe të ndryshimeve legjislative. Autoriteti është në pritje të miratimit të dy draftligjeve "Për tregun e titujve" dhe "Për sipërmarrjet e Investimeve Kolektive", dhe me miratimin e tyre, do të hartohet draft Manuali për Zbatueshmërinë, i cili do të përmbyll dhe fazën e 4 të këtij projekti, me dërgimin e tij përfaqësuesve të IOSCO-s.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj faze ishte dhe prezantimi i rasteve studimore nga secili vend përfaqësues dhe diskutimi lidhur me to. AMF prezantoi dy raste bashkëpunimi dhe dërgimi informacioni në lidhje me IOSCO-n. Kontributi i dhënë nga AMF u vlerësua nga përfaqësuesit e IOSCO-s, si në lidhje me rastet e prezantuara dhe korrektësinë në bashkëpunim, ashtu edhe për informacionin e dërguar gjatë fazës së dytë.

## Konferencë mbi tendencat e zhvillimeve të sigurimeve dhe ndikimi i tyre në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore

Në datat 14 -15 tetor 2019 në Vjenë, Austri, u zhvillua konferenca mbi tendencat e zhvillimeve të sigurimeve dhe ndikimi i tyre në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Konferenca u zhvillua në tre seanca. Seanca e parë konsistoi në diskutimin e çështjeve që lidhen me ndryshimet klimaterike, produktet inovative të cilat po zhvillohen në funksion të këtyre ndryshimeve.

Në seancën e dytë u diskutua mbi qeverisjen e mirë të korporatës në një epokë dixhitalizimi dhe ndryshimesh të modeleve të biznesit. U diskutua mbi rreziqet e reja, çështjet kryesore rregullatore dhe mbikëqyrëse në rajon.

Pyetësorët drejtuar pjesëmarrësve mbi qeverisjen e korporatave, kishin të bënin me:

- Shtysën kryesore të shoqërive të sigurimit për të përmirësuar qeverisjen e korporatës;
- Cilat mund të jenë pasojat më të rënda për një shoqëri e cila ka një qeverisje jo të mirë të korporatës;
- Cilat duhet të jenë prioritetet kryesore të autoriteteve mbikëqyrëse kur mbikëqyrin qeverisjen e korporatës së shoqërive të sigurimit;
- Cilat janë karakteristikat kryesore të një qeverisje efektive të korporatës;
- A e bën dixhitalizimi më të rëndësishme një qeverisje më të mirë.

Në seancën e tretë u diskutua mbi forcimin e kompetencave të konsumatorit sipas një rregullore të re të sjelljes dhe regjimit mbikëqyrës. U diskutua mbi informacionin kontraktual në një policë sigurimi dhe mjetet që duhet të përdoren në mënyrë që informacioni në policë të bëhet sa më i qartë dhe i lexueshëm.

---

Në datat 14 -15 tetor 2019 në Vjenë, Austri, u zhvillua konferenca mbi tendencat e zhvillimeve të sigurimeve dhe ndikimi i tyre në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

---

## Takimi i 18-të i Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore



Banka Kombëtare e Republikës Çeke zhvilloi në datat 9-10 tetor 2019 në Pragë, Çeki, takimin e 18-të të Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Banka Kombëtare e Republikës Çeke zhvilloi në datat 9-10 tetor 2019 në Pragë, Çeki, takimin e 18-të të Iniciativës së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

Qëllimi i takimit ishte jo vetëm prezantimi i temave të ndryshme, por edhe nxitja e bashkëbisedimit dhe ndarjes së eksperiencave të ndryshme ndërmjet përfaqësuesve të pranishëm.

Temat që u diskutuan në takim ishin:

- Vlerësimi i kërkesave të kapitalit: mjetet analitike;
- Mbikëqyrja e veprimtarive ndërkufitare;
- Transferimi i funksioneve (*outsourcing*), dilemat e mundshme dhe niveli i lejuar i aktiviteteve të jashtme;
- Shkollimi financiar/aktivitetet e edukimit të organizuara nga mbikëqyrësit;
- Kërkesat për IDD; kërkesa për trajnim profesional dhe zhvillim, si dhe çështje të licencimit.

Pjesëmarrja e ekspertëve të sigurimeve nga vende me tregje më të zhvilluara, ishte efikas në marrjen e shkëmbimin e informacioneve për ecurinë dhe stabilitetin e tregut të sigurimeve në Shqipëri sipas standardeve ndërkombëtare.

## Trajnim për hartimin dhe zbatimin e programit të edukimit financiar, kurs për hartuesit dhe zbatuesit e politikave

Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit (ITC-ILO) zhvilloi në datat 7-11 tetor, në Torino trajnimin për hartimin dhe zbatimin e programit të edukimit financiar, kurs për hartuesit dhe zbatuesit e politikave.

Pjesëmarrësit ishin përfaqësues të institucioneve të ndryshme mbikëqyrëse dhe rregullatore por edhe organizatave ndërkombëtare, të cilët diskutuan mbi përvojat e grumbulluara, mësimet e nxjerra dhe njohuritë e marra nga praktikrat më të mira aktuale, të cilat janë aplikuar nga institucione dhe aktorë të ndryshëm në mbarë botën. Trajnimi u bazua në përvojat e edukimit financiar gjatë dekadës së fundit të qendrës ITC-ILO dhe institucioneve të ndryshme apo praktikuesve të tjerë globalë. Gjatë trajnimit disa prej temave që u diskutuan ishin:

- Rritja e kompleksitetit të sektorit financiar dhe ndikimet në edukimin financiar dhe programet arsimore;
- Procesi i projektimit të një strategjie kombëtare;
- Përvojat globale;
- Marrëveshjet e ndryshme që mund të hartohen;
- Kuptimi i segmenteve dhe profilizimi i tyre;
- Roli i partneriteteve në hartimin dhe shpërndarjen;
- Shembuj dhe studime të rasteve të programe të ndryshme kombëtare dhe mësimëve të mësuara.

Programi i trajnimit në qendrën ITC-ILO për edukim financiar duke qenë një program gjithëpërfshirës kontribuoi në ndërtimin e kapaciteteve njerëzore në të gjitha nivelet, duke ndarë me pjesëmarrësit përvojën e akumuluar, mësimet e marra dhe praktikrat më të mira nga partnerët dhe institucionet zbatuese në të gjithë botën.

Qendra Ndërkombëtare e Trajnimit (ITC-ILO) zhvilloi në datat 7-11 tetor, në Torino trajnimin për hartimin dhe zbatimin e programit të edukimit financiar, kurs për hartuesit dhe zbatuesit e politikave.

## Takim shpjegues për kapitullin 6 “Legjislacioni tregtar”

Në datën 21 tetor, në Bruksel u zhvillua takim shpjegues për kapitullin 6 “Legjislacioni tregtar”, për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut. Në këtë takim u shpreh angazhimi për të vazhduar progresin e reformave në fushën e legjislacionit për shoqëritë tregtare, auditimit ligjor dhe raportimit financiar në dobi të bizneseve dhe transparencës në funksion të zhvillimit ekonomik. Gjatë takimit u diskutua:

- Për procedurat e brendshme dhe ndërkufitare të bashkimeve dhe ndarjeve të shoqërive me përgjegjësi të kufizuar;
- Për format e reja ligjore të aplikuara në BE, në forma të shoqërive evropiane, si dhe;
- Grupimet evropiane për interes ekonomik.

Në përfundim të takimit, përfaqësuesit e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut u përshëndetën edhe nga Drejtoresha për Ballkanin Perëndimor në Komisionin Evropian, znj. Genoveva Ruiz Calavera, e cila shprehu mbështetjen e plotë të Komisionit Evropian për të dy vendet e pranishme.

## Seminar për mbikëqyrjen e tregut të titujve

Komisioni Mbikëqyrës i Sektorit Financiar (CSSF) zhvilloi në datën 21 tetor, në Luksemburg seminarin për mbikëqyrjen e tregut të titujve. Gjatë seminarit u shkëmbyen eksperiencë, opinioneve, informacione të ndryshme në funksion të një mbikëqyrjeje efektive të tregut të titujve, duke u nisur edhe nga fakti se ky treg është relativisht i vogël, krahasuar me vendet e tjera. Ndër temat që u trajtuan në konferencë ishin:

- Pasqyrimi i tregut të titujve, si dhe kërcënimet dhe dobësitë e luftës për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit;
- Qasja dhe analiza drejt mbikëqyrjes me bazë rreziku për luftën e parandalimit të pastrimit të parave;
- Teknologjitë e reja për kategorizimin e rrezikut;
- Tipologjitë e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit në tregun e titujve;
- Rëndësia e bashkëpunimit ndërkombëtar në rastet e aktivitetit ndërkufitar për luftën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Komisioni Mbikëqyrës i Sektorit Financiar (CSSF) zhvilloi në datën 21 tetor, në Luksemburg seminarin për mbikëqyrjen e tregut të titujve.



## Java Globale e Investitorit 2019

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare përmbylli aktivitetet në kuadër të Javës Globale të Investitorit. Gjatë kësaj jave AMF organizoi takime me komunitetin e biznesit, universitetet publike dhe private, shkolla të mesme me profil ekonomik, si edhe pati prezantime mediatike në programe televizive dhe në disa nga edicionet e lajmeve.



*Z. Ervin Koçi dhe Z. Nikolin Jaka gjatë takimit informues me përfaqësues të bizneseve nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë së Tiranës dhe shoqatave të tregjeve nën mbikëqyrje, 30 shtator 2019.*



*Gjatë takimit informues me studentë e pedagogë në universitetin "Aleksandër Moisiu" në Durrës, 1 tetor 2019.*



*Gjatë takimit me studentë dhe pedagogë të Fakultetit të Ekonomisë të Universitetit të Tiranës, 2 tetor 2019.*





*Gjatë takimit informues me nxënës të Shkollës së Mesme Teknike Ekonomike në Tiranë, 3 tetor 2019.*



*Gjatë takimit informues me nxënësit e Shkollës së Mesme Profesionale "Kristo Isak" në Berat, 4 tetor 2019.*

## **Skema e Pensioneve në Bullgari**

Informacioni i mëposhtëm është sipas:  
<http://www.iopsweb.org>

<b>GDP për frymë (USD)</b>	<b>8,579</b>
<b>Popullsia (000)</b>	<b>7.050</b>
<b>Forca e punës (000)</b>	<b>3,357</b>
<b>Shkalla e punësimit (%)</b>	<b>66.9</b>
<b>Popullsia mbi 65 (%)</b>	<b>21.0</b>

Bullgaria është një prej vendeve ku është zbatuar Sistemi i Pensioneve prej III shtyllash. Ndarja e tyre bëhet si më poshtë:

### **Pensionet Shtetërore:**

Është një sistem PAYG ("Pay as You Go");

Mosha e pensionit në bazë të skemës së pensioneve të shtetit është 64 vjet dhe 1 muaj për burra dhe 61 dhe 2 muaj për gratë, me kusht që kërkesat për kohëzgjatjen e shërbimit kontribues të përmbushen. (38 vjet dhe 6 muaj shërbim kontribues për burra dhe 35 vjet dhe 6 muaj shërbim kontribues për gratë);

Personi i siguruar paguan 8.78% të ardhurave bruto për kontribut pensioni; të vet-punësuarit kontribuojnë 19.8% të të ardhurave të deklaruara, ndërsa punëdhënësit kontribuojnë 11.02% të pagave të përgjithshme.

### **Pensioni privat (I detyrueshëm):**

Dy lloje skemash pensionesh vullnetare të detyrueshme: universale dhe profesionale;

Skema universale: Këto fonde ofrojnë përfitime pensioni për të gjithë punonjësit, pavarësisht nga kategoria e punës. Fondet e pensioneve universale mbulojnë punonjësit e të vetëpunësuarit dhe pjesëmarrja është e detyrueshme për të gjithë punëtorët e lindur pas vitit 1959. Në tregun bullgar operojnë nëntë fonde pensioni universal që ofrojnë pensione të detyrueshme për 3,667,851 pjesëmarrës. Kontributet totale gjatë vitit 2017 arritën në 1.161 milion BGN (59.361 mijë euro);

Skema profesionale: E përcaktuar për ata që punojnë në një mjedis të rrezikshëm. I përket llojit të skemave DC (DC= Skema me kontribute të përcaktuara). Vetëm punëdhënësit kontribuojnë në fondet e pensioneve profesionale dhe niveli i kontributeve arrin në 12% për personat që punojnë në kushtet e kategorisë së punës I dhe 7% për kategorinë e punës II. Gjatë vitit 2017, kontributet arritën një total prej 102.7 milion BGN (52.5 milion euro) , ku kontributi mesatar mujor për anëtar ishte në vlerën 86.9 BGN (44.4 euro).

\*(Bullgaria bën një kategorizim të punonjësve në bazë të rrezikut të punës).

### **Pensioni privat (vullnetar):**

Kushdo që është mbi 16 vjeç mund të jetë pjesë e këtij plani;

Bazohet në një kontratë midis individit dhe një fondi pensioni (kompani administruese);

Kontributet nga punëdhënësit dhe kontributet nga palët e treta janë të mundshme;

Nivelet e kontributit përcaktohen në një kontratë midis fondit të pensionit dhe kontribuesit;

Nëntë fonde pensionesh vullnetare ofruan pensione për 614,761 anëtarë në vitin 2017. Shifra e totalit të investimeve nga nëntë fondet ishin në 994.7 milion BGN (50.858 milion Euro) në fund të vitit 2017. Nga ato investime, 40.7% janë bërë në formën e bonove dhe obligacioneve qeveritare, ndërsa 39.9% në formën e letrave me vlerë të tregtuara në tregun financiar.

### **Legjislacioni bazë:**

Të gjitha format e sigurimit të pensionit të pleqërisë të diskutuar rregullohen nga Kodi i Sigurimeve Shoqërore.

<https://nap.bg> › document

Autoriteti rregullator dhe mbikëqyrës është: Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare: [www.fsc.bg](http://www.fsc.bg)

## Skema e Pensioneve në Republikën Çeke

Informacioni i mëposhtëm është sipas:  
<http://www.iopsweb.org>

<b>GDP për frymë (USD)</b>	<b>35,000</b>
<b>Popullsia (000)</b>	<b>10,000</b>
<b>Forca e punës (000)</b>	<b>5,000</b>
<b>Shkalla e punësimit (%)</b>	<b>73</b>

### Pensionet publike

Skema e pensionit të përfitimeve të përcaktuara, PAYG (e ashtuquajtura shtylla e parë) bazohet në sigurimin e detyrueshëm të pensionit. Moshë e pensionit është 63 vjeç dhe 4 muaj për burrat dhe 62 vjet dhe 8 muaj për gratë pa fëmijë në 2018 (ulet deri në 4 vjet për gratë, në varësi të numrit të fëmijëve të rritur). Moshë e pensionit po rritet që nga viti 1996, ndërsa ritmi i rritjes është modifikuar disa herë. Legjislacioni i miratuar në vitin 2017 propozoi një masë që rrit moshën e pensionit në një mënyrë që do të pasqyroste më mirë jetëgjatësinë në ndryshim. Sipas ligjit të aprovuar, rritja e tanishme e moshës së pensionit do të vazhdojë derisa të arrijë 65 vjeç në 2030.

### Pensionet Vullnetare

Sistemi i pensioneve personale vullnetare është i disponueshëm për të gjithë, megjithatë kushtet janë të përcaktuara me ligj që të jenë të pranueshme për subvencionin shtetëror. Ka afërsisht 4.46 milionë pjesëmarrës në sistem (mars 2018).

Punëdhënësi nuk ka pse të kontribuojë. Ata mund të zgjedhin të paguajnë të gjithë, ose një pjesë të kontributit të punonjësit nëse ai ose ajo pajtohet, ndërsa marrëveshjet e negociatave kolektive gjithashtu mund të përcaktojnë që punëdhënësit të kontribuojnë. Kur individët nënshkruajnë një kontratë me një fond pensioni, ata angazhohen të paguajnë një kontribut mujor minimal prej 100 krona çeke. Niveli i përgjithshëm i kontributit përcaktohet në kontratën me shoqërinë administruese të fondit të pensionit. Shteti siguron subvencione në përputhje me shumën mujore të paguar nga pjesëmarrësi. Subvencioni maksimal i shtetit është 230 krona çeke në muaj. Kontributet mujore të pjesëmarrësve janë mesatarisht 670 krona çeke.

### Baza legjislative

<http://www.czechlegislation.com/act-no-586-1992-coll-on-income-taxes/>  
[https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p\\_lang=en&p\\_isn=83760&p\\_count=96684](https://www.ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=en&p_isn=83760&p_count=96684)  
[http://ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p\\_lang=en&p\\_isn=90678&p\\_country=CZE&p\\_count=261](http://ilo.org/dyn/natlex/natlex4.detail?p_lang=en&p_isn=90678&p_country=CZE&p_count=261)

## Skema e Pensioneve në Rumani

Informacioni i mëposhtëm është sipas:  
<http://www.iopsweb.org>

<b>GDP për frymë (USD)</b>	<b>23,197</b>
<b>Popullsia (000)</b>	<b>19,524</b>
<b>Forca e punës (000)</b>	<b>8,274</b>
<b>Shkalla e punësimit (%)</b>	<b>68.8</b>

Rumania është një prej vendeve ku është zbatuar sistemi i pensioneve me tre shtylla. Ndarja e tyre bëhet si më poshtë:

### Pensionet Shtetërore

Është një sistem PAYG ("Pay As You Go")

Kjo shtyllë siguron vetëm punonjësit që janë në marrëdhënie pune.

Pjesëmarrja është e detyrueshme për të gjithë ata nën 35 vjeç dhe vullnetare për grupmoshën 35-45 vjeç.

Kontributi në sistemin e pensioneve shtetërore është 5.1% i të ardhurave.

### Pensioni Vullnetar (I Detyrueshëm)

Ka filluar të funksionojë që prej vitit 2017.

Janë skema pensioni që bëhen me kontributin e enteve private ose publike për punonjësit e tyre.

Secili fond duhet të ketë minimalisht 100 anëtarë.

Këtu mund të kontribuojnë të punësuarit si edhe të vetëpunësuarit.

Nivelet e kontributit përcaktohen me marrëveshje nga të punësuarit me fondin e pensionit.

Këto përfitime mund të merren vetëm pasi është arritur mosha e pensionit.

### Pensioni privat (vullnetar)

Ka filluar të funksionojë që prej vitit 2006.

Menaxhohet vetëm nga ente private.

Një punonjës mund të kontribuojë deri në 15% të të ardhurave mujore.

Këto skema pensioni mund të administrohen nga një fond pensioni ose kompani sigurimi, i cili duhet të jetë i autorizuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes në Rumani.

### Legjislacioni i zbatueshëm

Ligji Nr. 52/2017 Shtesa ligjore

(<https://asfromania.ro/en/legislation/asf-legislation/2307-law-no-113-2013>)

Ligji Nr. 87/2015

Autoriteti rregullator është Autoriteti I Mbikëqyrjes së Rumanisë  
(<http://www.asfromania.ro/>)

## GLOBAL RISK REGULATOR

Volumi 17, tetor 2019 përmban këto shkrime kryesore:

- Shqetësimet e rregullatorëve financiarë lidhur me ndërlidhimet sistemike që mund të sjellë *cloud*

*(The cloud's systemic implications worry financial regulators)*

Artikulli vëren se “Cloud” nuk është kritik vetëm për sistemin financiar, por ai po luan një rol të madh në infrastrukturën dixhitale të ekonomisë botërore. Kalimi i institucioneve financiare në sistemet “Cloud”, ka qenë në radarin e rregullatorëve globalë, të cilët shqetësohen për rreziqet e përqendrimit.

- Shoqata për Tregjet Financiare në Evropë i kërkon BE-së mbështetje për “green securitisation” ndërsa rritet interesi i investitorit; Dalja e Britanisë së Madhe nga bashkimi Evropian e njohur si Brexit do të sjellë një zvogëlim të ndjeshëm të aktorëve në tregjet e kapitalit

*(AFME calls on EU to support green securitisations as investor interest grows; Brexit would leave the EU a significantly diminished capital markets player)*

- Autoriteti i Sjelljes Financiare të Mbretërisë së Bashkuar deklaron se “...Tregtimi i letrave me vlerë bazuar në informacione nga sondazhet ende të papublikuara mund të jetë një shkelje e rregullave dhe abuzim i tregut sipas standardeve të vendeve të BE-së.

*(Trading on prereleased polls is market abuse, says FCA)*

### Global Risk Regulator

A PUBLICATION FROM THE BANKER October 2019 | Volume 17, Issue 9

#### Contents

4 Regulatory  
9 Australia's bank  
10 Reform already  
11 Long resistance  
11 Australian banking  
11 Candidate goes  
12 Brexit a big boost  
12 Data changes split  
13 European traders  
14 The cloud  
14 Systemic  
15 Regulators worry  
15 financial regulators  
16 BIS publishes  
16 Reg guidance to  
16 support UK conduct  
16 rules  
16 Newsweek (17-20)  
16 ECB stimulus package  
16 Italy to exacerbate

#### Libor may yet have life beyond 2021

Pressure is steadily mounting to wean the financial system off Libor and onto alternative interest rate benchmarks, but the path remains strewn with tough obstacles suggesting that many users may not have switched by the regulators' deadline. By Justin Pugsley

The financial services sector is potentially facing a cliff edge with the UK's Financial Conduct Authority (FCA) warning that it will not issue on banks compelling and publishing the London interbank offered rate (Libor) after 2021. That raises the very real prospect that Libor will be discontinued by then, leaving major firms highly exposed and derivatives potentially up in the air if counterparties do not agree on how to shift exposures to alternative benchmarks.



Justin Pugsley

And if this work is not done in time it could be very disruptive, with some \$100s of financial transactions referencing Libor – the vast majority being swaps.

The FCA does appear to have left the door open for it to continue exerting pressure on the bank panels to publish Libor after 2021, albeit reluctantly. Many banks think this is sensible, but the FCA will probably only do so temporarily. So though potential disaster will likely be averted, the regulatory pressure for fast change will remain. Banks are reluctant to contribute to Libor panels for fear of raising into conduct issues that could lead to regulatory reprimands.

For some of the more complex to page 2



## **Bullgari**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Siguruesit në Bullgari kanë realizuar prime të shkruara bruto në vlerën 755.6 milionë euro në 6-mujorin e parë të vitit 2019, me një rritje prej 20.4%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Rritjen më të madhe e ka shënuar sigurimi MTPL.

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rritën me 18.3%, duke arritur në 135.8 milionë euro.

## **Evropa Qendrore dhe Lindore**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Evropën Qendrore dhe Lindore ruajti një trend pozitiv në 6-mujorin e parë të vitit 2019. Në total, primet e shkruara bruto u rritën me 6.11%, duke arritur në 19.68 miliardë euro. Edhe dëmet e paguara u rritën me të njëjtin ritëm, duke arritur në 11.75 miliardë euro.

Polonia mbetet në krye të listës së vendeve të rajonit përse i përket peshës në tregun e sigurimeve (me 38%), ndjekur nga Republika Çeke (16.57%), Hungaria (9.2%) dhe Sllovakia e Rumania, me respektivisht 5.87% dhe 5.78% të primeve të shkruara bruto.

Shteti me rritjen më të madhe në rajon për 6-mujorin e parë të vitit 2019 është Bullgaria, me një rritje prej 20.4% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

## **Greqi**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuara nga Shoqata Greke e Kompanive të Sigurimit, primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Greqi arritën në 2 miliardë euro, me një rritje prej 3.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës arritën në 1.05 miliardë euro, me një rënie prej 0.7%. Ndërsa primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës arritën në 949 milionë euro, me një rritje prej 10% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

## Kroaci

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Kroaci për 3-mujorin e tretë të vitit 2019 arritën në 8.15 miliardë kuna (HRK, monedha vendase) ose 1.1 miliardë euro, me një rritje prej 7.54% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlera e dëmeve të paguara arriti në 4.25 miliardë kuna, me një rritje prej 6.02% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 11.6%, duke arritur në 5.79 miliardë kuna. Ndërsa sigurimi i Jetës pësoi rënie me 1.28%, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

## Poloni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Primet e shkruara bruto për 6-mujorin e parë të vitit 2019 në tregun e sigurimeve në Poloni arritën në 7.56 miliardë euro, me një rritje prej 2.65% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Shkak i kësaj rritjeje u bënë primet në sigurimin e Jo-Jetës, që arritën në 5.07 miliardë euro, me një rritje prej 5.36%. Në anën tjetër, primet në sigurimin e Jetës pësuan rënie me 2.45%.

## Sloveni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Për 6-mujorin e parë të vitit 2019, primet e shkruara bruto në tregun e sigurimeve në Slloveni arritën në 1.3 miliardë euro, me një rritje prej 6.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Dëmet e paguara arritën në 784 milionë euro, me një rënie prej 0.6%. Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës ishin 374 milionë euro, me një rritje prej 5.2% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Sigurimi i Jo-Jetës arriti në 943 milionë euro, duke u rritur me 7.1%.

## Ukrainë

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Duke nisur nga 1 korriku 2020, në Ukrainë sigurimi i Kartonit Jeshil do të jetë i aksesueshëm *online*. Ai do të pranohet nga të gjithë autoritetet rrugore, që kontrollojnë si lëvizjet brenda vendit, ashtu edhe ato jashtë, njoftoi Drejtori i Përgjithshëm i Byrosë së Sigurimeve Motorike në Ukrainë.

Më 14 qershor 2019, autoritetet vendosën të ndryshonin formatin e policës ndërkombëtare të sigurimit. Digjitalizimi i këtij sigurimi i jep mundësi drejtuesve të mjeteve që ta marrin atë *online*, pa qenë nevoja të shkojnë fizikisht në zyrat e shoqërive të sigurimit.



---

**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)